

Data: 27.07.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Mirëmbajtja e sistemit DMDC në KESH për 3 vite dhe upgrade për integrimin e kapaciteteve të reja gjeneruese ”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Shërbime të tjera – 98390000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 179,800,000 (Njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëqind mijë) Lek pa TVSH ose 1,918,480 (Një milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 27/07/2026 është 93.72

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT.

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë operatori ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit :

Ligjin Nr. 29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar).

Vendim nr. 211, datë 9.4.2025 Për disa ndryshime në vendimin nr. 922, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Udhëzim nr. 24, datë 6.11.2025 për disa shtesa dhe një ndryshim në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kjo kërkesë ka si qëllim sigurimin e faktit që operatori ekonomik ka përvojë dhe aftësi të mjaftueshme për të realizuar kontrata të ngjashme me atë që po kërkohet. Në këtë mënyrë, AK synon të sigurojë se operatori ka kapacitetin për të përmbushur kërkesat dhe për të ofruar shërbime apo produkte që janë të ngjashme në natyrë dhe në vlerë me ato që janë të parashikuara në kontratë. Përvojat e mëparshme në kryerjen e shërbimeve të ngjashme janë një indikator i rëndësishëm i aftësisë së operatorëve për të menaxhuar projekte dhe për të përmbushur afatet dhe standardet e kërkuara. Nëse një operator ka një histori të suksesshme të realizimit të kontratave të ngjashme, kjo ul mundësinë e dështimit të kontratës së re, duke e bërë procesin më të sigurt dhe më të besueshëm për palën kontraktuese.

Operatorët ekonomikë që kanë përvojë të mëparshme në fushat e ngjashme janë më të besueshëm në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve që kërkohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për projekte që kërkojnë cilësi të lartë dhe përputhje me standardet. Përvoja e mëparshme tregon se operatori ka kapacitetin për të siguruar cilësinë dhe të përmbushë kërkesat kontraktuale.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

 SSH EN ISO/IEC 27001 “Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ”**Argumentimi:**

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Kërkesa në lidhje me këto certifikata mundëson një menaxhim të mirë të cilësisë, mbrojtje të mjedisit dhe siguri të punonjësve. Këto standarde janë të rëndësishme për të siguruar që operacionet e mirëmbajtjes të jenë efikase, të qëndrueshme dhe të sigurta për të gjitha palët e përfshira.

Konkretisht:

SSH EN ISO/IEC 27001 “Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ” – Ky standard është i nevojshëm për të garantuar që operatori ekonomik disponon një sistem të strukturuar dhe të certifikuar për menaxhimin e sigurisë së informacionit, identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të

sigurisë kibernetike, përcaktimin e masave të kontrollit dhe zbatimin e procedurave për mbrojtjen e informacionit gjatë realizimit të shërbimeve objekt kontrate.

SSH EN ISO/IEC 27001 në këtë kontekst siguron që të gjitha proceset që lidhen me mirëmbajtjen, administrimin, konfigurimin dhe aksesin në distancë të platformës SCADA DMDC realizohen në përputhje me praktikat ndërkombëtare të sigurisë së informacionit. Standardi ndihmon në zhvillimin dhe zbatimin e procedurave për kontrollin e aksesit të përdoruesve, menaxhimin e ndryshimeve në sistem, mbrojtjen e të dhënave, monitorimin e incidenteve të sigurisë dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit.

Duke qenë se platforma SCADA DMDC është pjesë e infrastrukturës kritike të informacionit dhe përdoret për monitorimin dhe kontrollin e proceseve të prodhimit të energjisë elektrike, zbatimi i këtij standardi garanton që ndërhyrjet teknike, konfigurimet software, administrimi i serverëve, databazave dhe pajisjeve të komunikimit realizohen nga një operator ekonomik që disponon procese të dokumentuara për ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit, duke reduktuar rreziqet e ndërprerjeve, aksesit të paautorizuar dhe incidenteve kibernetike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht për periudhën Maj 2026 - Korrik 2026, jo më pak se 1 (një) inxhinier elektrik dhe 1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacion.

-  1 (një) inxhinier mekanik;
-  1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacion

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

-  Kontratë pune të vlefshme;
-  Diplomë e inxhinierëve;
-  Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Maj 2026 - Korrik 2026.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Konkretisht:

Ky kriter është vendosur me qëllim garantimin që operatori ekonomik disponon kapacitetet e nevojshme profesionale dhe teknike për realizimin me cilësi të shërbimeve objekt kontrate, të cilat konsistojnë në mirëmbajtjen, administrimin, diagnostikimin dhe konfigurimin e një platforme komplekse SCADA/DMDC, të përbërë nga komponentë hardware, software dhe rrjete komunikimi industriale.

Platforma SCADA DMDC përbën sistemin qendror për monitorimin dhe kontrollin e HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës, duke qenë një element kritik për funksionimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të impianteve hidroenergjetike. Për shkak të rëndësisë operative të këtij sistemi, çdo ndërhyrje teknike kërkon njohuri të specializuara në fushat elektrike, elektronike, automatizimit dhe komunikimeve industriale.

Për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes preventive dhe korrigjuese, diagnostikimin e defekteve, analizimin e problematikave teknike, hartimin e raporteve të ndërhyrjeve dhe koordinimin teknik me prodhuesin e sistemit, është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij personel me formim universitar në fushat përkatëse, i cili disponon njohuritë dhe aftësitë teknike për identifikimin, analizimin dhe zgjidhjen e problematikave të platformës SCADA/DMDC.

Inxhinieri elektrik është i nevojshëm për:

- ✚ Analizimin dhe diagnostikimin e problematikave me natyrë elektrike që lidhen me furnizimin e pajisjeve të sistemit, ups-et, serverët, gateway-t, pajisjet e komunikimit dhe komponentët e tjerë hardware të platformës;
- ✚ Verifikimin e parametrave elektrikë dhe funksionimit korrekt të pajisjeve gjatë mirëmbajtjes preventive dhe korrigjuese;
- ✚ Identifikimin dhe interpretimin e anomalive elektrike që mund të ndikojnë në funksionimin e sistemit;
- ✚ Koordinimin e ndërhyrjeve teknike për rikthimin e sistemit në gjendje normale pune;
- ✚ Vlerësimin e ndikimit të problematikave të furnizimit elektrik në sigurinë dhe disponueshmërinë e platformës SCADA DMDC.

Inxhinieri Elektronik ose Telekomunikacioni është i nevojshëm për:

- ✚ Mirëmbajtjen, diagnostikimin dhe analizimin e komponentëve elektronikë, moduleve të komunikimit dhe elementëve software të platformës SCADA DMDC;
- ✚ Administrimin dhe diagnostikimin e komunikimeve industriale dhe protokolleve të komunikimit të përdorura nga sistemi, përfshirë IEC 60870-5-104 **Secure** dhe mekanizmat përkatës të sigurisë së komunikimit;
- ✚ Analizimin e problematikave që lidhen me rrjetet industriale, gateway-t, serverët, bazat e të dhënave dhe aplikacionet SCADA;
- ✚ Diagnostikimin e problemeve të transmetimit të të dhënave ndërmjet pajisjeve të terrenit dhe sistemit qendror të monitorimit;
- ✚ Verifikimin e konfigurimeve të komunikimit dhe ndërfaqeve ndërmjet komponentëve të ndryshëm të sistemit;
- ✚ Koordinimin teknik me prodhuesin e sistemit gjatë analizimit dhe zgjidhjes së problematikave që kërkojnë ndërhyrje të specializuara.

Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e këtij personeli teknik është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, e nevojshme dhe proporcionale, pasi garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale dhe teknike të nevojshme për mirëmbajtjen, administrimin dhe funksionimin e sigurt të një sistemi kritik të kontrollit dhe monitorimit të prodhimit të energjisë elektrike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij një minimum prej 2 (dy) specialist të certifikuar për sistemin PROZA NET nga prodhuesi i sistemit SCADA DMDC ose autoritete certifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi/t.

Argumentim: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedurë.

Konkretisht:

Kjo kërkesë është vendosur me qëllim garantimin që operatori ekonomik disponon personel me njohuri të specializuara dhe të certifikuara mbi platformën ekzistuese SCADA DMDC PROZA NET, e cila është objekt i kësaj kontrate.

Platforma SCADA DMDC PROZA NET përbën sistemin qendror të monitorimit dhe kontrollit të HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës, duke qenë një komponent kritik për funksionimin e sigurt dhe të vazhdueshëm të impianteve hidroenergetike. Sistemi përfshin komponentë të ndryshëm teknikë, si serverë SCADA, databaza, gateway komunikimi, licenca software, module aplikative, protokolle komunikimi industriale IEC 60870-5-104 Secure, si dhe standartet e sigurisë kibernetike.

Shërbimet objekt kontrate nuk kufizohen vetëm në mirëmbajtjen fizike të pajisjeve, por përfshijnë procese të avancuara teknike, si:

- ✚ Diagnostikimin dhe eliminimin e defekteve hardware dhe software;
- ✚ Administrimin, konfigurimin dhe parametrizimin e platformës scada;
- ✚ Mirëmbajtjen e databazave, moduleve të komunikimit dhe komponentëve software;
- ✚ Realizimin e backup-eve dhe rikthimin e konfigurimeve të sistemit;
- ✚ Integrimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në sistemin ekzistues;
- ✚ Zgjerimin dhe menaxhimin e licencave ekzistuese;
- ✚ Rikthimin e sistemit në funksionim pas defekteve, zëvendësimit të pajisjeve ose ndërhyrjeve teknike.

Platforma PROZA NET është një sistem specifik i prodhuesit dhe nuk mund të administrohet dhe mirëmbahet në mënyrë të sigurt vetëm mbi bazën e njohurive të përgjithshme mbi sistemet SCADA. Për këtë arsye, është e domosdoshme që ndërhyrjet teknike të realizohen nga personel i trajnuar dhe i certifikuar nga prodhuesi i sistemit, i cili disponon njohuri të detajuara mbi arkitekturën, konfigurimin, parametrizimin dhe procedurat e mirëmbajtjes së platformës.

Kërkesa për minimumi 2 (dy) Specialistë të certifikuar nga prodhuesi i sistemit SCADA DMDC PROZA NET ose autoritete certifikuese të tjera të njohura zyrtarisht nga prodhuesi/t. është vendosur për të garantuar:

- ✚ Vazhdimësinë e shërbimit dhe mbështetjen teknike edhe në rast të mungesës së njërit specialist;
- ✚ Disponueshmërinë e vazhdueshme të personelit të kualifikuar për ndërhyrje, diagnostikim dhe zgjidhje të problematikave gjatë gjithë periudhës së mirëmbajtjes;
- ✚ Reduktimin e rrezikut operacional që do të krijohej në rast të varësisë nga vetëm një specialist i certifikuar;
- ✚ Garantimin që ndërhyrjet në sistem të realizohen sipas procedurave teknike dhe rekomandimeve të përcaktuara nga prodhuesi i platformës.

Për rrjedhojë, ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, i nevojshëm dhe proporcional, pasi lidhet me kompleksitetin teknik të platformës SCADA DMDC PROZA NET, rëndësinë e saj për operimin e sigurt të sistemeve hidroenergjetike të KESH sh.a., si dhe me nevojën për të garantuar sigurinë, disponueshmërinë dhe vazhdimësinë e funksionimit të sistemit gjatë gjithë periudhës së kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për mallrat objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e një Autorizimi nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për mallrat objekt prokurimi është një kërkesë që ka si qëllim të sigurojë se operatori ekonomik ka akses dhe mund të ofrojë produkte të cilësisë së garantuar dhe të sigurta, si dhe të konfirmojë që ato janë në përputhje me standardet e prodhuesit ose distributorit.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga Grupi i punës (sipas procesverbalit pjesë integrale e kësaj procedure) ku në të citohet se:

Grupi i punës ka ndërmarrë procesin për hartimin e specifikimeve teknike për shërbimin e mirëmbajtjes 3-vjeçare të pajisjeve hardware dhe software për sistemin e kontroll-monitorimit ekzistues “PROZANET” SCADA DMDC në KESH Qendër Tiranë, qendrës së backup-it të SCADA DMDC të instaluar në HEC Vau i Dejës dhe integritit dhe vizualizimit të kapaciteteve të reja gjeneruese: TEC-et lundruese Tigër 1&Tigër 3 (totali i fuqisë aktive për të dyja), PV Qyrfaq, PV Zadejë dhe PV Karavasta.

Sqarojmë se KESH sh.a. është në një grup bilanci dhe palë përgjegjëse për balancimin e gjenerimit nga njësitë gjeneruese, ku përfshihet edhe sistemi fotovoltai në Karavasta, me fuqi të instaluar 140 MW.

Duke qenë se nëpërmjet platformës ekzistuese “PROZANET”, kryhet kontrolli dhe monitorimi i HEC-ve në distancë, gjithashtu monitorimi në kohë reale dhe vizualizimi i të dhënave dhe grafikëve të ndryshëm në video-wall, një sistem i nevojshëm dhe tepër i domosdoshëm për kontrollin dhe menaxhimin e prodhimit të energjisë elektrike nga operatorët e Dispeçerisë të KESH sh.a. për 3 HEC-et Fierzë, Koman dhe Vau i Dejës, dalim në përfundimin se kjo platformë është një nga sistemet më të rëndësishme për kontrollin dhe monitorimin e HEC-eve në KESH sh.a.

Platforma ekzistuese “PROZANET” SCADA DMDC është një platformë e nivelit të lartë të sistemeve SCADA, ku shpeshherë shfaqen probleme dhe difekte të ndryshme, të cilat pengojnë vazhdimin normal të punës së Dispeçerisë në KESH Qendër, si rrjedhojë pengojnë në përditësimin në kohë reale të gjenerimit të energjisë elektrike nga HEC-et dhe krahasimin

e tij me planifikimin e kryer, duke u bërë shkak për krijimin e disbalancave në Sistemin Energjitik që menaxhohet nga OST.

Për këtë arsye, për zgjidhjen e difekteve dhe problemeve teknike të platformës, zgjerimin e kapacitetit të sinjaleve të licensave ekzistuese, si dhe integrimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, është i nevojshëm kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes dhe suportit 3-vjeçar.

Në rast të defekteve ose dëmtimit të pajisjeve hardware të sistemit DMDC gjatë periudhës 3-vjeçare të mirëmbajtjes, do të jetë detyrë e OE që të kryejë riparimin e tyre ose zëvendësimin me pajisje të reja, kur pajisjet e dëmtuara nuk mund të riparohen, me qëllim rikthimin në gjendje normale pune të platformës DMDC “PROZANET” përfshirë pajisjet hardware dhe software të saj.

Aty ku pajisjet e reja kanë nevojë për konfigurime dhe parametrizime, do të jetë detyrë e operatorit ekonomik ti kryejë ato.

Për difektet dhe problematikat që do të shfaqen, shërbimet dhe suportin e mirëmbajtjes, kemi parashikuar edhe gjenerimin e raporteve 3-mujore ku të përshkruhen me detaje proceset e punëve gjatë shërbimeve të kryera, si edhe një vizitë vjetore në vend për çdo vit, ku të përshkruhen me detaje gjendja e platformës scada DMDC dhe zgjidhja e problemeve sipas dinamikave dhe problematikave të shfaqura.

Njësia e Prokurimit